



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 9 Maj 2023

RAPORT MBI GJETJET DHE KONKLuzionet Kryesore

“Monitorimi i të drejtave dhe lirive të shtetasit të paraburgosur J.R. gjendja shëndetësore e të cilit u përkeqësua pas qëndrimit prej afro 5 ditësh në ambientet e Bllokut të Sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë së Tiranës”

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në përmbushje të misionit të tij, ndërmori një mision monitorimi pas disa sinjalizimeve në media se shtetasi me inicialet J.R, i minoritetit Rom, i arrestuar më datë 12.04.2023, për veprën penale të vjedhjes, ndodhet i shtruar në spital në gjendje të rëndë. Ky shtetas aktualisht është duke marrë mjekim të specializuar mjekësor pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT).

Grupi i vëzhguesve të KShH, i përbërë nga dy juristë dhe një mjek, ndërmori një mision monitorimi në institucionet si vijon: Blloku i Sigurisë i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe gjithashtu pranë kësaj Drejtorie, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) 302 dhe 313 (Mine Peza dhe Jordan Misja). Gjithashtu u mor takim edhe me avokatin e caktuar nga familjarët e tij.

KShH vëren se shtetasi J.R kishte mbërritur në ambientet e Bllokut të Sigurisë në datën 12.04.2023, pasi ishte arrestuar në flagrancë për veprën penale “Vjedhje” nga punonjësit e Komisarariatit nr. 2. Në datën 13.04.2023, në orën 08:30 mjeku i Bllokut të Sigurisë ka realizuar vizitën e parë mjekësore brenda afatit prej 12 orësh nga momenti i ndalimit/arrestimit¹, gjatë së cilës, J.R. ka deklaruar se ishte përdorues i lëndëve narkotike si dhe trajtohej me antidotë, metadon pranë Qendrës “Aksion Plus”. Sipas pohimit të autoriteteve, kjo qendër është e vetmja në vend që trajton pacientë me antidotë, metadon.

Mjeku i Bllokut të Sigurisë konfirmoi për vëzhguesit e KShH se shtetasi J.R është trajtuar konform praktikës së bashkëpunimit me Qendrën Aksion Plus² me antidotë, metadon, me një dozë prej 40 mg në ditë, çdo 24 h, në tre ditë, gjatë kohës që ka qënë i akomoduar në Bllokun e Sigurisë, në datat 13.04.2023, 14.04.2023 dhe 15.04.2023. Kjo praktikë nuk është e formalizuar në ndonjë protokoll të veçantë mjekësor apo marrëveshje bashkëpunimi me Qendren, sipas pohimeve të

¹ Parashikuar në pikën 7.2 të nenit 7 të Urdhërit 925, datë 18.07.2019, “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”

² Pasi është marrë informacion prej saj në rrugë verbale me anë të një telefonate mes mjekut të Bllokut të Sigurisë dhe një përfaqësuesi të kësaj qendre



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

përfaqësuesve të DVP Tiranë. Vëzhguesi i KShH-së, në profilin mjek, vërejtë se ndaj J.R nuk është realizuar një analizë urine toksikologjike-ligjore apo konsultë me specialistin toksikolog për mënyrën e trajtimit me antidotë.

Gjatë qëndrimit në Bllokun e Sigurisë, J.R ka shfaqur shqetësimet e para shëndetësore në orët e para të mëngjesit të datës 14.04.2023, të cilat janë evidentuar nga rojet e sigurisë. Shtetasi ka pasur dridhje trupi dhe për këtë arsye është njoftuar urgjenca. Mjeku i urgjencës së QSUNT që ka trajtuar shtetasin J.R në datën 14.04.2023 ka shënuar në Librin e Vizitave Mjekësorë të Bllokut të Sigurisë trajtimin me me “*solucion diazepam*”. Nuk rezulton nga të jetë specifikuar doza e këtij mjekimi, kërkesë kjo e protokolleve mjekësore.

Vëzhguesit e KShH verifikuan kartelën shëndetësore nr.950 të hapur për këtë shtetas në datën 13.04.2023 kur i është kryer vizita e parë mjekësore, ku figuron kjo vizitë por nuk është pasqyruar në vijim, trajtimi që ky shtetas ka marrë nga mjeku i institucionit apo nga urgjenca e QSUNT. Në vlerësimin e KShH-së, trajtimi mjekësor për çdo të ndaluar/arrestuar të akomoduar në ambientet e Komisariateve të Policisë së Shtetit, duhet të evidentohet në mënyrë dinamike në kartelën shëndetësore të tyre, edhe në rastet e ofrimit të shërbimit nga mjekët e institucionit apo mjekët e qendrave spitalore në rastet e urgjencave. Kjo do të mundësonte verifikimin e mjekimit që është ofruar për J.R dhe rrjedhimisht edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së mjekimit nga institucionet kompetente (si psh në rastin e hetimit të pretendimeve të familjarëve nga prokuroria).

Në datën 15.04.2023 shtetasit J.R ju caktua masa e sigurisë “Arrest në Burg” nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë. Në paraditën e datës 16.04.2023 (ora 10:35) Blloku i Sigurisë ka nisur procedurën e transferimit të shtetasit J.R pranë ambienteve të një IEVP-je³, më konkretisht pranë IEVP 313 Tiranë. Ndërkohë që shtetasi është kthyer sërish në ambientet e Bllokut të Sigurisë rreth një orë më vonë (11:25). Rezulton se me anë të një procesverbali të marrjes në dorëzim, Blloku i Sigurisë ka transportuar drejt IEVP 313 tre shtetas të cilët do duhej të akomodoheshin pranë kësaj IEVP-je. Dy prej këtyre shtetasve ishin pranuar nga ana e IEVP-së 313, **ndërkohë shtetasi J.R nuk ishte pranuar të akomodohej**. Sipas “*Raport shoqërimi*” të autoriteteve të policisë, IEVP 313 kishte refuzuar ta pranonte me pretendimin se ishte përdorues i lëndëve narkotike. Të dhëna të tjera kontradiktore janë vërejtur nga monitorimi, sipas të cilave, IEVP 313 nuk ka akomoduar J.R për shkak të mbipopullimit⁴.

³ Pasi prokurori i çështjes ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të masës së sigurisë Sipas parashikimeve të pikës 13.1, të nenit 13, kapitulli V, të Urdherit nr. 925, datë 18.07. 2019, “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

⁴ Sipas komunikatës zyrtare të Policisë së Shtetit, por edhe nga ana e drejtuesit të IEVP 313 (gjatw takimit me vzhguesit e KShH)



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KShH vëre nse nga njëra anë punonjësit e policisë së shtetit të Bllokut të Sigurisë referojnë si shkak refuzimi të akomodimit të J.R pranë IEVP 313, faktin se ky shtetas është përdorues i lëndëve narkotike, ndërkohë që përfaqësuesit e sistemit penitenciar (IEVP) 313 deklarojnë se shkak ka qenë mbipopullimi.

Lidhur me mbipopullimin, vëzhguesit e KShH verifikuan se IEVP 313 nuk ishte realisht në kushte të tilla, pasi sipas një Urdhëri të Brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, IEVP 313 ka një kapacitet akomodues prej 480 individësh, ndërkohë që në këto ambiente ndodheshin faktikisht 430 shtetas, pra 50 shtetas më pak se kapaciteti maksimal akomodues⁵.

Ndërkohë, edhe pse nuk ishte transferuar fizikisht për në IEVP 302 që ndodhet po në Tiranë në afërsi të godinës së Bllokut të Sigurisë, autoritetet e policisë në të njëjtin raport shërbimi janë shprehur se IEVP 302 nuk pranon këtë kategori të arrestuarish dhe J.R deklaroi se tek 302 ka hasëm. Për KShH është e paqartë shprehja “këtë kategori të arrestuarish” dhe marrja e mirëqenë e pohimeve të pretenduara nga i arrestuari për hasmëri, pa kryer verifikime lidhur me bazueshmërinë e tyre.

KShH vlerëson se shtetasit e paraburgosur me vendim gjykate, nuk mund të refuzohen nga asnjë Institucion Ekzekutimi i Vendimeve Penale. KShH, ndër vite ka realizuar monitorime në shumë IEVP, pranë të cilave ka konstatuar edhe mbipopullim, por ky nuk ka qenë asnjëherë shkak të dijeninë tonë që një person me masë sigurie arresti të caktuar nga gjykata të kthehet nga IEVP, për të qëndruar në ambientet e dhomave të sigurisë të Policisë së Shtetit. Rrjedhimisht, qëndrime të tilla si në rastin në fjalë, ndaj një shtetasi të Minoritetit Rom, vartës ndaj lëndëve narkotike, krijojnë dy standartizim në praktikën e autoriteteve dhe dyshime të arsyeshme, për trajtime të diferencuara me qasje diskriminuese ndaj tyre.

Një ditë pasi është refuzuar pranimi i këtij shtetasi nga IEVP 313 dhe IEVP 302, në orët e para të mëngjesit të datës 17 Prill 2023 (04:15), shtetasi J.R është konstatuar nga policët e dhomave të sigurisë në kushtet e simptomave shëndetësore problematike, duke vjellë dhe duke gulçuar, kishte puls të dobët dhe frymëmarrje të dobët. Pasi i është dhënë ndihma e parë nga policët roje të dhomave të sigurisë është njoftuar ambulanca e cila ka mbërritur në ambientet e Bllokut të Sigurisë në orën 04:28 dhe në orën 04:33 është realizuar transportimi i këtij shtetasi në urgjencën e QSUNT.

Dy ditë më pas, në datën 19.04.2023, nëpërmjet një komunikimi me email të realizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me IEVP 313 dhe IEVP 302, rezulton se për këtë shtetas,

⁵ Vëzhguesit e KShH verifikuan pranë IEVP 313, kapacitetin faktik akomodues bazuar në një komunikatë përmbledhëse 12 orëshe, nr.1092 prot, datë 18.04.2023, për fashën orare orare 07:00-19:00 të datës 16.04.2023.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

gjatë kohës që ka qenë i shtruar në QSUNT është pranuar në IEVP 302, pas ngritjes së një komisioni pritjeje nga IEVP 302.

Gjatë monitorimit të zhvilluar në ambientet e Bllokut të Sigurisë monitoruesit e KShH u njohën me dy shkresa të cilat Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë i dërgonte Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat evidentuan vonesat e transferimit drejt IEVP-ve të dy shtetasve të ndaluar, për të cilët kishte vendime të formës së prerë të dënimit me burgim. Me shkresën nr. 5207 prot. datë 28.04.2023, kërkohet nxjerrja e urdhërit të transferimit për shtetasin V.Q dhe që ishte akomoduar në ambientet e Bllokut të Sigurisë në datën 27.04.2023. Me shkresën nr. 4969 prot. datë 25.04.2023 kërkohet transferimi i shtetasit R.S i akomoduar pranë Bllokut të Sigurisë nga data 21.04.2023.

Vonesat e konstatuara për transferimin e këtyre shtetasve dhe në mënyrë të veçantë arsyet jo të bazuara në ligj për refuzimin e pranimit të shtetasit të Minoritetit Rom, J.R në ambientet e IEVP 302 dhe 313, e kanë vendosur atë në kushtet e kufizimit të paligjshëm të lirisë në ambientet në të cilat është mbajtur (Bllokut të Sigurisë). Sipas nenit 28 të Kushtetutës, personit, të cilit i është hequr liria (në kushtet të ngjashme me shtetasin J.R) duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim. Në rastin e J.R, gjykatës i është dashur afro 3 ditë (brenda afatit kushtetues) të vendosë për paraburgimin e tij, por ai ka vijuar të mbahet tej këtij afati në Bllokun e Sigurisë, në kushte paligjshmërie, duke cenuar detyrimet që burojnë nga neni 22, pika 1, gërma “d”, të ligjit nr.79/2020 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”, sipas të cilit ekzekutohet me urdhër të gjykatës menjëherë pas shpalljes, vendimi penal që miraton kërkesën e prokurorit për masën e sigurimit me arrest⁶.

Në mënyrë të veçantë, mbajtja në ambientet e sigurisë të policisë së Shtetit (Blloku i Sigurisë), të shtetasve të dënuar me vendim të formës së prerë dënimi apo, për shkak të vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”, përbën shkelje të të drejtave të tyre, të parashikuara në ligjin 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

Si rrjedhojë, shtetasi J.R. është privuar nga katalogu i të drejtave dhe kushtet e trajtimit që duhet ti ofrohet një shtetasi me masë sigurie arrest në burg, në sistemin penitenciar sipas ligjit nr.81/2020.

⁶ Gjithashtu, sipas nenit 24 të ligjit nr.81/2020, “Ekzekutimi i vendimeve penale kryhet vetëm në vendet e caktuara posaçërisht sipas këtij ligji që janë IEVP-të. Përgjashtimisht, ministri i Drejtësisë, në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, të forcës madhore, kryerjes së punimeve të rëndësishme, si dhe kur rrezikohet jeta dhe shëndeti i të burgosurit, mund të urdhërojë që ekzekutimi i vendimeve penale të kryhet përkohësisht në vende të tjera të përshtatshme, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë ligj”.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ndër to është edhe detyrimi që kanë institucionet e sistemit penitenciar të sigurojnë kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve. Organizimi dhe realizimi i kujdesit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit në bashkëpunim me qendrën spitalore të burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë.

Gjithashtu, kjo situatë përbën regres në raport me konkluzionet që Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT) ka konstatuar në raportin e tij për Shqipërinë të afro 5 viteve më parë (Nëntor të 2018-ës). Në këtë raport, KPT-ja vëren me kënaqësi se, ndryshe nga situata e konstatuar gjatë vizitave të mëparshme, të paraburgosurit zakonisht transferoheshin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale pa vonesë dhe periudha aktuale e ndalimit policor në përgjithësi nuk i kalonte afatet ligjore. **KPT beson se autoritetet shqiptare do të vazhdojnë përpjekjet e tyre për t'i dhënë fund përfundimisht praktikës së mbajtjes së të paraburgosurve dhe të dënuarve në ambientet e ndalimit në institucionet e policisë⁷.**

Vëzhguesve të KShH nuk iu mundësua dhënia e informacionit të shpejtë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me denoncimin e familjarëve të shtetasit J.R (të realizuar me anë të avokatit), gjë që do t'i shërbente sqarimit të çështjes. KShH rithekson qëndrimin e mëparshëm, se qasja e përsëritur edhe më herët nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që KShH të paraqesë kërkesë zyrtare me shkrim, për informacione që disponohen aty për aty nga ky organ dhe nuk përbëjnë sekret hetimor, dëmton aktualitetin e monitorimit dhe reagimit në kohë të një organizate të njohur në publik për misionin dhe veprimtarinë e saj.

Për shkak të rëndësisë që ka kjo çështje për opinionin publik dhe të drejtat e liritë e njeriut, KShH i sugjeron Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si organi i ndjekjes penale që për akte që nuk përbëjnë sekret hetimor, të informojë publikun për veprimet që ka kryer dhe po kryen kjo prokurori për çështjen dhe sidomos familjarët e shtetasit J.R.

⁷ Paragrafi 12, fq.13 e Raportit <https://rm.coe.int/168097986b>